



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

### **EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 21. 2.2013, e cila filloi në orën 15:00.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:** Sami Hamiti, Mustafë Krasniqi, Tefik Mehmeti, Hazir Borovci, Aziz Pacolli, Milazim Vitia, Shemsi Veseli dhe Shefqet Sylejmani.  
Mungoi: Engin Beyoglu.

**Në mbledhje morën pjesë edhe** drejtorët e drejtorive të Komunës dhe përfaqësuesit e OSBE - së.

**Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Sami Hamiti, kryesues.**

Para se të fillonin me rendin e ditës, kryesuesi propozoi që në pikën e nëntë të rendit të ditës, të shqyrtohet edhe Propozimvendimi për lejimin e mjeteve kompanisë rajonale të mbeturinave “Pastrimi” SHA në Prishtinë.

**Njëzëri u miratua ky**

#### **REND DITE :**

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë;**
- 2. Propozimvendimi për ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale;**
- 3. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të shkollës fillore dhe të mesme të muzikës dhe të baletit “Prenk Jakova” në Prishtinë;**
- 4. Propozimi për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim;**
- 5. Propozimvendimi për rritjen e të hyrave vetjake dhe bartjen e mjeteve nga viti 2012 në vitin 2013;**
- 6. Propozimvendimi për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim;**
- 7. Propozimvendimi për bibliotekën komunale “Hivzi Sylejmani” në Prishtinë;**
- 8. Propozimvendimi për teatrin e qytetit “Dodona” në Prishtinë;**
- 9. Propozimvendimi për lejimin e mjeteve kompanisë rajonale të mbeturinave “Pastrimi” SH.A. Prishtinë;**
- 10. Të ndryshme.**

## **Pika e parë**

**Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë.**

## **Pika e dytë**

Arsyetimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës e paraqiti **Agim Salihu**.

**Shemsi Veseli**, shprehu mendimin se për veprimtaritë, siç janë kazinotë dhe lojërat e fatit, ngarkesat të jenë më të larta, e assesi të stimulohen dhe të barazohen me veprimtari të tjera.

**Shefqet Sylejmani**, u shpreh se në arsyetim do të duhej të sqarohej se çfarë po dëshirohet të arrihet me këtë propozim. Në 40.11 - shpërndarja e energjisë elektrike, të paraqiten shpjegime plotësuese. Në 51.46 - tregti me shumicë ... dhe 52.31 - tregti me pakicë ..., çmimet të jenë më të përafërta, por edhe te ndërmarrjet e shërbimeve hoteliere dhe motelet, si dhe në 66.03, veprimtaritë duhet të përafrohen. Ngarkesat për bastore dhe lojëra të fatit, duhet të jenë më të larta.

**Aziz Pacolli** tha se edhe herëve të tjera ka kërkuar që të stimulohen zanatet e vjetra dhe të mos ngarkohen me tatim, ndërsa sa i përket lojërave të fatit dhe bastoreve, kërkoi që tarifat të jenë më të larta.

**Kryesuesi dhe Agim Dibrani** paraqitën sqarime shtesë.

**U konstatua se u përkrah njëzëri Propozimvendimi për ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi Agim Salihu.**

**Mustafë Krasniqi** tha se si shkollë ka nevojë për hapësirë më të madhe, andaj a është menduar për ndonjë lokacion tjetër dhe pse nuk ka mundur të realizohet propozimi i mëparshëm?

**Bexhet Musliu** u përgjigj në pyetjen e parashtruar.

**Aziz Pacolli** shtoi se lokacioni më i mirë i propozuar ka qenë ai te "Tauk-bahçja". Është caktuar lokacion tjetër dhe përsëri është kthyer propozimi i mëhershëm, duke theksuar se këto ndërrime të lokacionit janë të tepruara dhe ai objekt është bërë i rrezikshëm për ata fëmijë.

**Tefik Mehmeti** u pajtua me mendimin e Mustafë Krasniqit, që të gjendet hapësirë më në periferi për shkolla të mesme. Ai përkrahu miratimin e propozimit.

**U konstatua se u përkrah Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të shkollës fillore dhe të mesme të muzikës dhe të baletit "Prek Jakova" në Prishtinë dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

## **Pika e katërt**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës të pranishmit i informoi **Agim Salihu**, i cili ndër të tjera tha se nën II, pika 3 duhet të hiqet.

**Aziz Pacolli** tha se në bazë të certifikatës, nuk po dihet se e kujt është prona, andaj duhet të precizohet më mirë.

**Kryesuesi** sqaroi se këto prona janë komunale dhe do t'u nënshtrohen procedurave të ankandit.

**Shemsi Veseli** kërkoi informacion shtesë lidhur me heqjen e pikës së rendit të ditës, që ka të bëjë me dhënien e disa pronave komunale në shfrytëzim, duke thënë se do të jetë i rezervuar sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, sepse mungon sqarimi, dhe shprehu dilemën se ka prona të uzurpuara, gjë që nuk do të duhej të krijohet mundësia të legalizohen. Ai gjithashtu kërkoi që të jepet sqarim për lagjet dhe zonat ku gjenden ato. Duhet të jemi të kujdesshëm dhe transparenca duhet të jetë në nivelin e duhur.

**Kryesuesi** paraqiti sqarime shtesë.

**Shefqet Sylejmani** përkrahu mendimin e Shemsi Veselit, se në mungesë të informacioneve mund të gabohet, andaj duhet të pasur transparencë më të madhe dhe do të duhej të jepej shpjegim plotësues. Në arsyetim do të duhej të cekej se do të shqyrtohet në komision.

**Mustafë Krasniqi** shprehu mendimin se do të duhej të jepeshin disa të dhëna plotësuese, në mënyrë që pronat të identifikohen më lehtë.

**Tefik Mehmeti** tha se ky është një propozim që e ka bërë ekzekutivi, që pronat e propozuara komunale të ndahen, ndërsa e jona është që t'i zbatojmë procedurat dhe paqartësitë do të spastrohen deri në Kuvend.

**Shiqeri Spahiu** paraqiti sqarime shtesë.

**U konstatua se u përkrah propozimi për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

## **Pika e pestë**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës të pranishmit i informoi **Xhelil Bektshi**. Ndër të tjera, ai tha se kjo gjendje e mjeteve të bartura mund të ndryshojë për shkak të ndryshimit të parasë në transfere dhe barazimeve të gjendjes në Ministrinë e Financave - Departamenti i Thesarit. Për çdo ndryshim, deri ne mbledhjen e Kuvendit, do ta pasqyrojmë me të dhëna.

**Kryesuesi** shtoi se në pjesën tekstuale kemi dhënë edhe arsyeshmërinë, por kjo është një pasqyrë e përmbledhur në bazë të kodeve.

**Shemsi Veseli**, në parim u pajtua me këtë propozim, por do të duhej të bëhej një performancë edhe më e mirë e planifikimit të projekteve. Shprehu mendimin se do të duhej tërhequr vërejtja sidomos prokurimit, në mënyrë që të arrijë në kohë. E përkrahu propozimin, sidomos për projektin e blerjes së autobusëve.

**Shefqet Sylejmani** shtoi se Drejtoria duhet të përgëzohet për punën e bërë, ku janë ngërthyer të gjitha pikëpamjet e duhura, por është mirë që të publikohet dhe të jepen shpjegime plotësuese lidhur me pengesat ligjore. Në pjesën e të dhënave për projekte, si blerja e autobusëve, është shumë e qëlluar dhe është mirë që të bëhet edhe ndonjë harmonizim i punëve të Trafikut Urban dhe Stacionit të Autobusëve. Ai shprehu me dhe shtoi se duhet të subvencionohen më shumë ato zeje që janë në shuarje. Te programi i Shërbimeve Publike kërkoi që linja “Kodra e Diellit-Akademia e Shkencave -Plepat-Gërmia është mirë të realizohet . Te programi për Rini dhe Sport propozoi që dekorimi i qytetit të bëhet edhe në pjesët periferike të qytetit.Fusha sportive e premtuar në kompleksin banesor “Dielli” kërkoi që të realizohet si dhe tabela për mbledhje të Kuvendit të rregullohet teknikisht.

**Tefik Mehmeti** tha se shumica e mjeteve janë të dedikuara për investime kapitale . Mosshpenzimi i buxhetit dhe bartja e tijë në vitin e ardhshëm bëhet nga njerëzit që i njohin mirë financat . Është një planifikim i mirë me koncept të qartë. Mjetet janë mirë të planifikuara por shpesh lindin edhe probleme andaj nuk duhet bërë presion që të bëhen pagesa para kohe.

**Aziz Pacolli** kërkoi që për mbledhjen e Kuvendit gjërat të sqarohen më mirë dhe kërkesat të finalizohen.

**U konstatua se u përkrah Propozimvendimi për rritjen e të hyrave vetanake dhe bartjen e mjeteve nga viti 2012 në vitin 2013 , me ndryshime dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

## **Pika e gjashtë**

**Tefik Mehmeti** paraqiti arsyeshmërinë e këtij propozimi duke theksuar se Kompania AMM është kompani përzgjedhëse e cila ka ofruar cmimin më të lartë.

**Aziz Pacolli** propozoi që të vihen edhe cmimet ofruara nga kompanitë tjera konkurruese.

**Shemsi Veseli** tha se kontrata e lidhur në mes të Komunës dhe AMM-së është mirë që tu përcillet pasi që nuk po na vijnë përgjigjet se a po kryhen obligimet në raport me Komunën, sa është hapësira shfrytëzuese sa bill-borde ka , sa është çmimi etj.

**Shefqet Sylejmani** shtoi se duhet të kihet kujdes që reklamat mos ti pengojnë të tjerët.

**Bexhet Musliu** tha se këtij propozimi duhet ti shtohet “të vendoset në bazë të Planit Rregullues”.

**Tefik Mehmeti** paraqiti sqarime shtesë.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

#### **Pika e shtatë dhe e tetë**

Arsyeshmërinë lidhur me këto pika të rendit të ditës e paraqiti **Agim Salihu**.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për bibliotekën komunale "Hivzi Sulejmani" në Prishtinë dhe Propozimvendimi për teatrin e qytetit "Dodona" në Prishtinë dhe i dërgohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

#### **Pika e nëntë**

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për lejimin e mjeteve kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi" SH.A. në Prishtinë dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

#### **Të ndryshme**

##### **Pika dhjetë**

**Shefqet Sylejmani** kërkoi që Komisioni Komunal të përfundoi punën në përcaktimin e pronës në Kompleksin banesor "Dielli" në "Kodrën e Diellit". Gjithashtu kërkoi që NPL "Hortikultura" ta rregulloi parkun në kompleksin banesor "Dielli". Që inspekcioni të kryej punët në lagjen "Tophane" lidhur me largimin e kamionëve, traktorëve dhe punëtorëve të krahut nga kjo lagje si dhe shtroi pyetjen se e kujt është prona në lagjen "Tophane" pas bibliotekës "Hivzi Sulejmani".

**Bexhet Musliu** informoi lidhur me pyetjet e shtruar që kanë të bëjnë me kompleksin banesor "Dielli" në "Kodrën e Diellit".

**Shemsi Veseli** kërkoi që të ndërmerren masa dhe mos të lejohet që kontejnerët të mbështeten në shtëpinë e një personi të paralizuar në afërsi të "Rezonancës".

*Mbledhja mbaroi në orën 17:15.*

**PROCESMBAJTËSE:**

**Alije Gusia**

**KRYESUESI I KOMITETIT**

**Sami Hamiti, ecc. i dipl.**

Faqe 5 nga 5